

VENDIM
Nr. 107, datë 23.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 42, DATË 17.1.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË
PUNËSIMIT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 42, datë 17.1.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
1. Neni 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 12

Këshilli administrativ trepalësh është organi më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ai përbëhet nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit. Anëtarë të tjerë të këshillit janë, si më poshtë vijon:

- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- 1 përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës;
- 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- 1 përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- 2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve;
- 2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve.

Mandati i anëtarëve të këshillit është trevjeçar dhe miratimi i tyre, pas propozimit nga institucionet/organizatat e sipërpërmendura, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore duhet të jenë në nivel zëvendësministri ose nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese. Shpërblimi për pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij sipas rregullores së funksionimit të tij.”.

2. Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Këshilli mbledhet, të paktën, 4 (katër) herë në vit. Mbledhja e këshillit thirret dhe drejtohet nga kryetari i këshillit administrativ, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të SHKP-së.

Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit por, në çdo rast, duhet të jenë të pranishëm, të paktën, 1 (një) anëtar, përfaqësues i organizatave të punëdhënësve dhe 1 (një) anëtar, përfaqësues i organizatave të punëmarrësve. Vendimet e këshillit administrativ trepalësh nënshkruhen nga kryetari i këshillit.

Mbledhja e këshillit administrativ trepalësh dokumentohet nga sekretariati.”.

3. Neni 23 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 23

SHKP-ja bashkëpunon me institucione të ndryshme shtetërore si edhe me organizata joqeveritare, shqiptare apo të huaja, që kryejnë veprimtari në fushën e punësimit ose në fusha të ngjashme me të dhe mund të lidhë marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

4. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohen me fjalët “... ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit ...” dhe “... ministri përgjegjës për çështjet e punësimit ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama